



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2025

V E N D I M

Nr. 19, datë 03. 11 .2025

P Ë R

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT “ANALIZË E TREGUT TË TELEFONISË FIKSE -
TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT DHE TRANZITIMIT TË THIRRJEVE NË
RRJETET TELEFONIKE PUBLIKE NGA VENDNDODHJE FIKSE - DOKUMENT
PËRFUNDIMTAR”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Gentian	Sala	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
3. Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4. Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5. Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Xhilda Hoxha në mbledhjen e datës 03.11.2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.2.2017 si dhe ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse - Dokument Përfundimtar*”

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 87 e në vijim i Kreut XIII-të “Analiza e Tregut dhe Fuqia e Ndjeshme në Treg”, Kreu XIV-të, “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);
3. Rregullore nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, e ndryshuar;
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse - Dokument Përfundimtar*” i cili përmban si Aneks 2: Komentet në Konsultim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr.11, datë 27.08.2025, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të Dokumentit “*Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse— Këshillim Publik*”.
2. Këshillimi Publik u krye për një periudhë 45 ditore, më datë 28.08.2025 - 12.10.2025. Në përfundim të Këshillimit Publik, në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr.763/3prot., datë 29.09.2025 (*referenca e AKEP nr.1406 prot., datë 2.10.2025*), One Albania sh.a me shkresën nr.2036 prot., datë 10.10.2025 (*referenca e AKEP nr.1464 prot., datë 13.10.2025*) si dhe Vodafone Albania sh.a me shkresën Ref: LEA/LEA/090/L.R E.MA., datë 6.10.2025 (*referenca e AKEP nr.1438 prot., datë 7.10.2025*).
3. Nga komentet e palëve të interesuara vërehet se, në përgjithësi, ato janë dakord me përfundimet e AKEP dhe me masat e propozuara për rregullimin e tregjeve të telefonisë fikse. Megjithatë, ka dhe qëndrime të ndryshme lidhur me aspekte të caktuara të rregullimeve të propozuara nga AKEP, të shoqëruara me sugjerime përkatëse. Komentet e plota të palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP ndaj tyre janë paraqitur në Aneksin II të dokumentit përfundimtar të Analizës së Tregut.
4. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse – Dokument Përfundimtar*”:

- a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar në një periudhë 45 ditore, datë 28.08.2025 - 12.10.2025, si dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 2, i dokumentit).
 - b. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në Ligjin nr. 54/2024 si dhe Rregulloren për Analizën e Tregut 9/2009;
 - c. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut ne nenet 87 e në vijim i Kreut XIII-të, “Analiza e Tregut dhe Fuqia e Ndjeshme në Treg”, Kreu XIV-të, “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, të Ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” si dhe listën e tregjeve të përcaktuara ne Rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, e ndryshuar, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut ne Shqipëri;
 - e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 92, Kreu XIV “Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg”, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr.54/2024.
5. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse – Dokument Përfundimtar*” përmban:
- përkufizimin e tregjeve përkatëse të analizuar: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse;
 - analizë e konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT) për operatorët pjesë e tregjeve të analizuar;
 - arsyetimin dhe përfundimin se One Albania si dhe Operatorët Alternative (OA) përmbushin kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale fikse, përfshirë arsyetimin për masat rregulluese për FNT për terminimin e thirrjeve (kombëtare) në rrjetet fikse.
 - arsyetimin dhe përfundimin për de-rregullim të tregut me shumicë të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse si dhe tërheqjen e masave rregulluese për operatorin One Albania në këtë treg, brenda një afati kohor të përcaktuar në VKD-në e miratimit të dokumentit përfundimtar të analizës.
 - masat rregulluese për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT, si dhe skemën e reduktimit të tarifave për terminimin fikse në rrjetet individuale të ofruesve të këtij shërbimi, *glide path* (FTR).
 - Aneks 1. Lista e sipërmarrësve të rrjeteve publike telefonike fikse të propozuar për status me FNT në terminimin e thirrjeve.

- Aneks 2: Komentet në Konsultim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet.
6. Dokumenti: “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe masat rregulluese, kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikave 1 të nenit 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Vendimi nr. 74, datë 1.10.2018 “Për miratimin e dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse”, shfuqizohet.
3. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohen në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al;

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka